



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më ____ / ____ /2018

V E N D I M

Nr. 32 , Datë 26 / 01 / 2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10021, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr.06, datë 15.01.2018, të paraqitur nga subjekti ankues N.Sh, kundër Njesisë Administrative Postribë, Shkodër, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “bindjes politike”. Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës së paraqitur nga N.Sh, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, në formularin e ankesës, subjekti ankues deklaroi se: *“Me shkresën nr.87, datë 09.01.2015 është njoftuar nga Komuna Postribë për zgjidhjen në mënyrë të menjëhershme të kontratës së punës për arsye të përgjysmimit të buxhetit të komunës. Më vonë për këtë çështje i është drejtuar administratorit të Njesisë Administrative Postribë dhe Bashkisë Shkodër por që nuk ka gjetur zgjidhje. Pas kësaj ka kërkuar nga drejtoresha e shkollës që të mbledhë bordin e shkollës në prani dhe të administratorit të Njesisë Administrative Postribë, A.Sh, i cili gjatë takimit është shprehur se: “Nuk dua ta dëgjoj emrin tënd as unë as Kryetarja e Bashkisë. Vetëm nëse të futë Edi Rama”. Që nga dita që është larguar nga puna e në vazhdim, N.Sh vazhdon të punojë në shkollë pa pagesë. Për shkak të shtimit të numrit të nxënësve, në shkollë është shtuar dhe një punonjëse tjetër e cila paguhet privatisht nga prindërit e nxënësve. Me anë të një kërkesë padie, N.Sh i është drejtuar dhe Gjykatës së Shkallës së Parë, Shkodër. N.Sh pretendon se diskriminimi ka ndodhur për çështje politike, pasi nuk ka patur asnjëherë vërejtje në punë”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rikthimin në vendin e punës dhe pagesën për periudhën që nga largimi e në vazhdim.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën,*

ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

Në bazë të nenit 7, të Ligjit 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet nga çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë.

Bazuar në formularin e ankesës nr. 06, datë 15.01.2018, si dhe dokumentacionit dërguar në mbështetje të pretendimeve të saj, Komisioneri vlerëson se, N.Sh është vënë në dijeni për sjelljet diskriminuese nga ana e Komunës Postribë, që në datë 09.01.2015, periudhë kur N.Sh është vënë në dijeni për zgjidhjen e marrëdhënieve të punës.

Për sa më sipër, referuar nenit 33 pika 4/dh të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” i cili citon se “Ankesa nuk pranohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se një vit nga marrja dijeni nga i dëmtuari, për këtë fakt”, ankesa nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenin 33, pika 4/dh të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Mospranimin e ankesës së N.Sh, për shkak se është e papajtueshme me dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI